



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT

Data 29.07.2026

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE): OUE, NUIS K17529215O, me **përqindje: 48%**, adresa Kukes Kukes SHEMRI Lagjja Shemri, Rruga Nacionale Shemri-Kukes Km2, Zona Kadastrale Nr.3335, Nr.Pasurie 593/1 & **SHPRESA - AL**, NUIS K31321021N, me **përqindje: 52%**, adresa Tirane Tirane Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2.

Operatorit Ekonomik (OE) ☐ ose

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë: **OUE**, NUIS K17529215O, me **përqindje: 48%**, adresa Kukes Kukes SHEMRI Lagjja Shemri, Rruga Nacionale Shemri-Kukes Km2, Zona Kadastrale Nr.3335, Nr.Pasurie 593/1 & **SHPRESA - AL**, NUIS K31321021N, me **përqindje: 52%**, adresa Tirane Tirane Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2.

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Pune

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-84018-05-01-2026. Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sistemim – asfaltim rruge te brendshme fshati Nikoliq, Njesia Administrative Golaj, Bashkia Has”, afati për zbatimin e saj 8 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës [Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës] Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 05-05-2026.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Buletini Nr. 31 datë 11 Maj 2026 [Data] [Numri].

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. LIQENI VII

K01730502W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 73,109,921.88 (Shtatëdhjetë e tre milion e njëqind e nente mijë e nentëqind e njëzetë e një pike tetëdhjetë e tete) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. ALMO KONSTRUKSION

J91915001P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 74,278,036 (Shtatëdhjetë e katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e tete mijë e tridhjetë e gjashtë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. BAMI HOLDING

J94416206R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 87,390,976.66 (Tetedhjetë e shtatë milion e treqind e nentëdhjetë mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pike gjashtëdhjetë e gjashtë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. CURRI

J67902718S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 62,222,137 (Gjashtëdhjetë e dy milion e dyqind e njëzetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. RSM COMPANY

810802422

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 62,638,659 (Gjashtëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nente) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. BOE RAFIN COMPANY & B93 II & GRAMA

L52125110A / L52209050O / J77304712J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 62,820,959.52 (Gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e njëzetë mijë e nentëqind e pesëdhjetë e nente pike pesëdhjetë e dy) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

7. BOE GRIALD & INA

J68117216C / J61814009W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 67,568,602 (Gjashtedhjetë e shtatë milion e pesëqind e gjashtedhjetë e tete mijë e gjashtëqind e dy) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

8. BOE MARSI & MELA.

J68028214P / K62320011G

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 69,216,169 (Gjashtedhjetë e nëntë milion e dyqind e gjashtembëdhjetë mijë e njëqind e gjashtedhjetë e nëntë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

9. BOE DESARET COMPANY & LAÇAJ

K01816001J / J67019018L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 73,227,891 (Shtatedhjetë e tre milion e dyqind e njëzetë e dy mijë e teteqind e nëntedhjetë e një) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

10. BE - IS SH.P.K

K71412003A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 74,415,392 (Shtatedhjetë e katër milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntedhjetë e dy) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

11. BOE OUE & SHPRESA - AL

K175292150 / K31321021N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 81,043,374.58 (Tetedhjetë e një milion e dyzetë e tre mijë e treqind e shtatedhjetë e katër pike pesedhjetë e tete) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

12. PE - VLA - KU

K61716013M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 75,233,154.08 (Shtatedhjetë e pesë milion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e pesedhjetë e katër pike zero tete) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO X JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat: SAJS, me Nipt K92316501M, 50% nenkontraktimi

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

13. VELLEZERIT HYSA

K12911201C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 77,891,696.36 (Shtatedhjetë e shtatë milion e teteqind e nentedhjetë e një mijë e gjashtëqind e nentedhjetë e gjashtë pike tridhjetë e gjashtë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

14. Shendelli

K07924803N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 78,025,646.64 (Shtatedhjetë e tete milion e njezete e pese mije e gjashteqind e dyzete e gjashte pike gjashtedhjetë e kater) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

15. FUSHA

J61922018S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 85,241,033.7 (Tetedhjetë e pese milion e dyqind e dyzete e nje mije e tridhjetë e tre pike shtate) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

16. BOE DRINI-1 & NDREGJONI & UDHA

J78716317H / K31329048I / K77524909Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 88,772,566.15 (Tetedhjetë e tete milion e shtateqind e shtatedhjetë e dy mije e pesëqind e gjashtedhjetë e gjashtë pike pesëmbëdhjetë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

17. Ormir HOXHA

M51601020K

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 0.0 (Zero) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. LIQENI VII

K01730502W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 73,109,921.88 (Shtatëdhjetë e tre milion e njëqind e nente mijë e nentëqind e njëzetë e një pike tetëdhjetë e tete) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar vlerësimin në sistem në datë 03/07/2026, nga ku rezulton se nga dokumentacioni i paraqitur dhe oferta ekonomike operatorit ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. me nipt K01730502W është kualifikuar dhe renditur e para. KVO në zbatim të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, me njoftimin date 03.07.2027 drejtuar operatorit ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. me nipt K01730502W (i klasifikuar i pari ne renditje pas procesit te vleresimit te procedures se prokurimit), të paraqisë të gjitha dokumentat origjinale ose kopje të njehsuara me origjinalin, që provojne kërkesat të cilat janë plotësuar me vetedeklarim sipas shkronjave “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2, te nenit 26 si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në SPE pranë Bashkisë Has brenda datës 07.07.2026. Operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. me nipt K01730502W ka paraqitur dokumentacionin prane zyres se protokollit Bashkia Has me date 07.07.2026. Nga vlerësimi i dokumentacionit fizik te dorezuar nga operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. me nipt K01730502W, rezulton se nuk ploteson kriteret e veçanta per kualifikim, konkretisht: Se pari, operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.2.3 Operoret Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 dhe kestet e maturuara për vitin 2026. Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik të formularit përmbledhes të vetedeklarimit sipas shtojces përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.** Nga verifikimi i dokumentacionit fizik te dorezuar nga operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. rezulton se nuk ka paraqitur vertetim per pagimin e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2025, 2026 nga Bashkia Tirane, pasi referuar ekstraktit mbi historikun rezulton se gjate kesaj periudhe ka ushtruar aktivitet.

Se dyti, operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.3.3/b Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë**

personelin kryesor, drejtues teknik të cilet të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

➤ Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
➤ Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastruktura	1 (një)
➤ Inxhinier Gjeodet / Topograf	1 (një)
➤ Inxhinier Mjedis	1 (një)
➤ Inxhinier Hidroteknike	1 (një)

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). *** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. rezulton se për plotësimin e kriterit Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastruktura ka dorëzuar dokumentacion për drejtuesin teknik L.M. i cili rezulton të jetë i diplomuar Inxhinier Ndërtimi, dhe jo Inxhinier Ndërtimi profili Infrastruktura.

Se treti, operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3/c Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të përcaktoje me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i Shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperience) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.*** Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. rezulton se nuk është paraqitur deklarata për përcaktimin e drejtuesit teknik.

Se katërti, operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3/d Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 16 (Gjashtembedhjete) punonjes të kualifikuar për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certificate trajnimi (të vlefshme), ose Deshmi Profesionale lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, si më poshtë:

Teknik Ndërtimi	1 (nje)
Teknik Topograf	1 (nje)
Hidraulike	1 (nje)
Karpentier	2 (dy)
Asaltoshtrues	3 (te)
Betonues	2 (dy)

Specialist Ndertimi
Shofer

3 (tre)
3 (tre)

Shoferet për drejtim mjetesesh duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. **Shënim:** Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektivit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik "LIQENI VII" sh.p.k. rezultojnë se për plotësimin e kërkesës për disponimin e Teknik Ndertimi është paraqitur dokumentacion për Inxhinier Ndertimi A.Gj. kurse për plotësimin e kërkesës për disponimin e Teknik Topograf është paraqitur dokumentacion për Inxhinier Topograf E.M. Pra, jo në përputhje me kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Se pesti, operatori ekonomik "LIQENI VII" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojë tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Nr kontrates Profesionit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik "LIQENI VII" sh.p.k. rezultojnë se nuk është paraqitur tabela me të dhënat sa më sipër.

Se gjashti, operatori ekonomik "LIQENI VII" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3/g Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimit të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjës si më poshtë: 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimit si "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik "LIQENI VII" sh.p.k. rezultojnë se nuk është paraqitur dëshmi/ certifikatë trajnimit të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit për K.Sh.

Se shtati, operatori ekonomik "LIQENI VII" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.4 Makineri Pajisje Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas

tabeles se mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. rezulton se nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për disponimin e mjeteve si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 Ton	copë	2
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton	copë	2
5	Autobetoniere	copë	2
6	Autopompe betoni	copë	1
8	Grejder	copë	1
10	Rrul vibrues gome cilinder mbi 18 ton	copë	1
17	Eskavator me goma	copë	1

Se teti, operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor sidhe të dekalroj dhe vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara në këtë procedure prokurimi nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. rezulton se nuk ka paraqitur deklaratat sa më sipër.*

Se nenti, operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim *Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me menyren e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues). Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Bashkise Has, e përcaktuar edhe tek Pika 2.10 e DST-së. Financimi është parashikuar në Buxhetin 2026-2028, afati i realizimit është 8 muaj. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. rezulton se nuk ka paraqitur deklaratën ku të shprehet se është dakort me menyren e financimit dhe pranimin e realizimit të objektit brenda afatit të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Për sa më sipër, u procedua me skualifikimin e operatorit ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. për mungesë të dokumentacionit për plotësimin e kriterëve për kualifikim dhe me ri-vlerësimin e procedurës së prokurimit.*

2. ALMO KONSTRUKSION

J91915001P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 74,278,036 (Shtatedhjetë e kater milion e dyqind e shtatedhjetë e tete mije e tridhjetë e gjashtë)
Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si me poshte:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar rivlerësimin në sistem në datë 13/07/2026, nga ku rezulton se nga dokumentacioni i paraqitur dhe oferta ekonomike operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. me nipt J91915001P është kualifikuar dhe renditur e para. KVO në zbatim të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, me njoftimin date 13.07.2027 drejtuar operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. me nipt J91915001P (i klasifikuar i pari ne renditje pas procesit te rivleresimit te procedures se prokurimit), të paraqisë të gjitha dokumentat origjinale ose kopje të njehsuara me origjinalin, që provojne kërkesat të cilat janë plotësuar me vetedeklarim sipas shkronjave “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2, te nenit 26 si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në SPE pranë Bashkisë Has brenda datës 17.07.2026. Operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. me nipt J91915001P ka paraqitur dokumentacionin prane zyres se protokollit Bashkia Has me date 16.07.2026. Nga vleresimi i dokumentacionit fizik te dorezuar nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. me nipt J91915001P, rezulton se nuk ploteson kriteret e veçanta per kualifikim, konkretisht: Se pari, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3 *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë: a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar të paktën 60 (Gjashtedhjetë) punonjes me kohe të plotë duke përfshire dhe stafin teknik, për periudhen e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mësipërme në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:*

- *Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.*
- **Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.**

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik te dorezuar nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. rezulton se nuk ka dorezuar listë pagesat e punonjësve për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Se dyti, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3 b) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet*

të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** të cilet të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

➤ Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
➤ Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastruktura	1 (një)
➤ Inxhinier Gjeodet / Topograf	1 (një)
➤ Inxhinier Mjedisi	1 (një)
➤ Inxhinier Hidroteknike	1 (një)

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). *** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. rezulton se nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Se treti, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3 e) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 16 (Gjashtëmbëdhjetë) punonjes të kualifikuar për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certifikate trajnimi (të vlefshme), ose Dëshmi Profesionale lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, si më poshtë:

Teknik Ndërtimi	1 (nje)
Teknik Topograf	1 (nje)
Hidraulike	1 (nje)
Karpentier	2 (dy)
Asfaltoshtues	3 (tre)
Betonues	2 (dy)
Specialist Ndërtimi	3 (tre)
Shofer	3 (tre)

Shoferet për drejtim mjetesesh duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi me kategorine “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE” lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor. Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. **Shënim:** Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t’i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës. *** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e

dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik te dorezuar nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. rezulton se nuk ka dorezuar asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Se katerti, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3 **f)** *Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të pakten:*

- Ekskavatoriste 3 (tre)
- Automakinist 3 (tre)

*të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontrate pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës. Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontrate pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik te dorezuar nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. rezulton se nuk ka dorezuar asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.*

Se pesti, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3 **g)** *Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:*

- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkepunimit.
- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

*Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër. *** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik te dorezuar nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. rezulton se nuk ka dorezuar asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.*

Se gjashti, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3 **h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik te dorezuar nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. rezulton se nuk ka dorezuar asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.**

Se shtati, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.3.4 Makineri Pajisje** Operatori Ekonomik pjesëmarres duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:**

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier”, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|---------|
| ➤ Kokore minimumi | 60 copë |
| ➤ Prozhektorë ndriçimi natën minimumi | 4 copë |
| ➤ Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi | 5 copë |
| ➤ Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi | 20 copë |

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëhësuar me origjinalin, si më poshtë: Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesinë e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm). Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm). Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik te dorezuar nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. rezulton se nuk ka dorezuar asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Se teti, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.3.7** Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë: - Tuba metalik D=219mm; - Tombino me tuba betoni Ø 800. **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhena të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.*
- *Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*
- *Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë çertifikatë nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik "ALMO KONSTRUKSION" sh.p.k. rezulton se nuk ka dorëzuar autorizim nga prodhuesi për distributorin e autorizuar për materialet Tuba metalik D=219mm. Për sa më sipër, u proçedua me skualifikimin e operatorit ekonomik "ALMO KONSTRUKSION" sh.p.k. për mungesë të dokumentacionit për plotesimin e kriterëve për kualifikim dhe me ri-vlerësimin e proçedures së prokurimit.

3. CURRI

J67902718S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 62,222,137 (Gjashtedhjetë e dy milion e dyqind e njetë e dy mijë e njetë e tridhjetë e shtatë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si me poshte:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë proçedurë prokurimi, rezulton se nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht:

Se pari, operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.2 *Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:*

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- **Kategoria NP- 1** Punime germimi në toke **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP- 4** Rrugë, autostrada, mbikalime, **Klasifikimi C**
hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
- **Kategoria NP- 5** Punime nëntokësore, ura e vepra arti **Klasifikimi A**

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- **Kategoria NS- 4** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, **Klasifikimi A**
rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese
- **Kategoria NS- 6** Sinjalistika rrugore jodriçuese **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS- 7** Barriera dhe mbrojtje rrugore **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** Punime topogjeodezike **Klasifikimi A**

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. ka paraqitur Licensen e zbatimit NZ.0005/28 e lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Energji me datë 18.08.2025, e cila ka afat vlefshmerie deri me date 25.05.2026. Afati i fundit për paraqitjen e ofertave për këtë procedure prokurimi është data 25.05.2026.

Se dyti, operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3 **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:**

- a) *Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar të paktën 60 (Gjashtedhjetë) punonjes me kohe të plotë duke përfshirë dhe stafin teknik, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mësipërme në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:*

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit sipas Shtojca 8, numrin e punonjësve që ka të punësuar për muajin Mars dhe Prill 2026, në kundërshtim me kërkesat për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Se treti, operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.3.4 Makineri Pajisje** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier”, si më poshtë vijon:

➤ Kokore minimumi	60 copë
➤ Prozhektorë ndriçimi natën minimumi	4 copë
➤ Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi	5 copë
➤ Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi	20 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesinë e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm). Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata perkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm). Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. nuk ka paraqitur numrin e kontrates noteriale të qerase apo nuk ka vetedeklaruar kontraten përkatëse noteriale të qerasë objekt i këtij prokurimi për mjetet Autobetoniere, Autopompe betoni, Sperkates boje për vijeze në rruge. Për mjetet autobetoniere dhe auto pompe betoni ka deklaruar kontrate qeraje të lidhur me qiradhenesin “Albabeton” sh.p.k. me datë 14.10.2022, pra në kundërshtim me kërkesat për kualifikim të përcaktuara për këtë procedurë prokurimi. Për mjetin “Sperkates boje për vijeze në rruge” nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit Shtojca 8 numrin e kontratës noteriale me qiradhenesin “Albanian Traffic Solution” sh.p.k.

Se katërti, operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.5 *Operatoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:*

- *Çertifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Çertifikate ISO 14001-2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- ***Çertifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Pune”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.***
- *Çertifikate ISO 39001-2012 Per menaxhimin e Sigurisë së Qarkullimit Rrugor, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Certifikata iso 45001-2018 CS 014 09.11.2023 nuk është e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, pasi afati i vlefshmerisë së kësaj certifikate është me datë 16.05.2026. Procedura e prokurimit është zhvilluar me datë 25.05.2026.

Se pesti, operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.7 *Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë: - Tuba metalik D=219mm; - Tombino me tuba betoni Ø 800. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve.*

Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. **Shënim:** Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë çertifikatë nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria. Operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. për plotësimin e këtij kriteri "Tuba metalik D=219mm" ka paraqitur dokumentacion nga kompania Kaz Group. Dokumentacioni i paraqitur është i pa përkthyer në gjuhën shqipe, në kundërshtim me kërkesat e veçanta për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji", Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s' kualifikimin e operatorit ekonomik

4. RSM COMPANY

810802422

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 62,638,659 (Gjashtedhjetë e dy milion e gjashtëqind e tridhjetë e tete mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nente) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi, rezulton se nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht:

Se pari, operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: Ofertuesi ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k. ka paraqitur preventivin e punimeve në formularin e ofertes me njësi të ndryshuar nga ato të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, konkretisht,

Sipas Preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor, është përcaktuar:

Shtrese çakelli t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri per bankina, B=50cm – **njesia m2**

Sipas preventivit të ofertes ekonomike të paraqitur nga ofertuesi ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k. është përcaktuar:

Shtrese çakelli t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri per bankina, B=50cm – **njesia m3**

Ndryshimet e preventivit të publikuar nga AK në njësi apo sasi nga operatorët ekonomik gjatë paraqitjes së ofertave ekonomike janë në kundërshtim me DST, konkretisht:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

B. PËRGATITJA E OFERTAVE

- 3. Dokumentet përbërëse të Ofertës** Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor.

6. Çmimet

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

- 18. Përgjegjshmëria e ofertave** 1. Një ofertë e përgjegjshme/ vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) **"Devijim"** është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;

Se dyti, operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika **2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Operatori ekonomik "RSM Company" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, nuk ka paraqitur Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar për Bilancin e vitit 2025, në kundërshtim edhe me përcaktimet e Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Se treti, operatori ekonomik "RSM COMPANY" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika 2.3.3 e) *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 16 (Gjashtembëdhjetë) punonjës të kualifikuar për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certificate trajnimi (të vlefshme), ose Dëshmi Profesionale leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, si më poshtë:*

<i>Teknik Ndertimi</i>	<i>1 (nje)</i>
<i>Teknik Topograf</i>	<i>1 (nje)</i>
<i>Hidraulike</i>	<i>1 (nje)</i>
<i>Karpiertier</i>	<i>2 (dy)</i>
<i>Asfaltoshtrues</i>	<i>3 (tre)</i>
<i>Betonues</i>	<i>2 (dy)</i>
<i>Specialist Ndertimi</i>	<i>3 (tre)</i>
<i>Shofer</i>	<i>3 (tre) 2</i>

*Shoferet për drejtim mjetesh duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi me kategorinë "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor. Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, leshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. **Shënim:** Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës. *** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Operatori ekonomik "RSM Company" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht, nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcë 8 disponimin Teknik Topograf. Ky operator ekonomik ka deklaruar Z. Shkelqim Deçka me profesion Inxhinier Topograf.

Se katërti, operatori ekonomik "RSM COMPANY" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika 2.3.4 **Makineri Pajisje** *Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makinë dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:*

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier", si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 60 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëhësuar me origjinalin, si më poshtë: Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesine e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm). Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm). Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Konkretisht, nuk ka paraqitur numrin e kontrates noteriale të qerase (Rep. / Kol.) / furnizimit apo nuk ka vetedeklaruar kontraten përkatëse noteriale të qerasë objekt i këtij prokurimi për mjetet:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 Ton	copë	2
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton	copë	1
4	Autovinc	copë	2
5	Autobetoniere	copë	2
6	Autopompe betoni	copë	1
7	Autobot uji	copë	1
8	Grejder	copë	1
10	Rrul vibrues gome cilinder mbi 18 ton	copë	1
11	Rrul cilinder cilinder me kompresor deri 10 ton	copë	1

12	Rrul cilindër gome me vibrim mbi 10 ton	copë	1
13	Autobitumatriçe	copë	1
14	Asfaltoshtruese	copë	1
17	Eskavator me goma	copë	1
18	Fadrome me goma	copë	1
19	Minieskavator/minifadrome	copë	2
21	Fabrike për prodhimin e materialeve inerte, të pajisur License nga QKL, Leje Mjedisore kategoria B	copë	1
22	Fabrikë për prodhimin e Asfaltit, e pajisur me leje mjedisore nga QKL	copë	1
23	Impiant për prodhimin e Betonit, të pajisur me leje mjedisore nga QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronësine. Në rast se impianti i prodhimit të betonit është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerave.	copë	1

Se pesti, operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika 2.3.5 *Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:*

- Çertifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 14001-2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Punë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 39001-2012 Për menaxhimin e Sigurisë së Qarkullimit Rrugor, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto çertifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar. Nga operatori ekonomik, nuk janë paraqitur çertifikatat ISO sa më sipër për RSM Construction dhe shoqërisë më.

Se gjashti, operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika 2.3.6 *Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.*

Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion ku të provoj se është i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Autoriteti kontraktor, ka përcaktuar në DST, pika:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohej të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë:

Ofertuesve nuk u lejohej të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë:

- Kapaciteti ekonomik dhe financiar, Pikat 2.2.1, 2.2.2, Shtojca 7 e DST-së.
- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas Pikës 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të KVK, Shtojca 7 e DST-së.
- Licencat e kërkuara sipas pikës 2.3.2/a, 2.3.2/b, 2.3.4 të Kapacitetit Teknik të KVK, Shtojca 7 e DST-së.
- Staf i teknik i kërkuar sipas pikës 2.3.3 / b të Kapacitetit Teknik të KVK, Shtojca 7 e DST-së.

Ofertuesve nuk u lejohej të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për pikat si më sipër, pasi përvoja për të zbatuar kontratën, licencat dhe stafi teknik vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standardeve të kërkuara.

Se shtati, operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika 2.3.7 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë: - Tuba metalik D=219mm; - Tombino me tuba betoni Ø 800, **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.*
- *Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.*

- *Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë çertifikatë nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.*

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar. **Shënim:** Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.*

Për artikullin: Tuba metalik D=219mm nuk ka paraqitur çertifikatë nga Prodhuesi Italinox Shqiperia shpk që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Për artikullin: Tombino me tuba betoni Ø 800 nuk ka paraqitur çertifikatë nga Prodhuesi Kurti Uniblllok shpk që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015.

Se teti, operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, *Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën **ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).** Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Bashkisë Has, e përcaktuar edhe tek Pika 2.10 e DST-së. Financimi është parashikuar në Buxhetin 2026-2028, afati i realizimit është 8 muaj. Ky operator ekonomik, nuk ka paraqitur deklaratën ku të pranojë se është dakort për realizimin e punimeve sipas menyrës së financimit të objektit.*

Se nenti, operatori ekonomik “RSM COMPANY” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: Subjekti mbështetet Aurora Konstruksion shpk në Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit Shtojca 8 nuk ka përcaktuar rolin që do të ketë në këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu, rezulton se ka vetedeklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit Shtojca 8 në seksionin **Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Makineri e mjete

Po [] Jo []

Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete

Dhe në C Deklarate

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME

PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Autobetoniere me targa AB448IC, AB901CT. Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’ kualifikimin e operatorit ekonomik

5. BOE RAFIN COMPANY & B93 II & GRAMA

L52125110A / L52209050O / J77304712J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 62,820,959.52 (Gjashtedhjetë e dy milion e teteqind e njetëzete mijë e nentëqind e pesëdhjetë e nente pike pesëdhjetë e dy) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si me poshte:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi, rezulton se nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: Se pari, bashkimi i operatoreve ekonomik “Rafin Company” sh.p.k. & “B93II” sh.p.k. & “Grama” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: bashkimi i operatoreve ekonomik “Rafin Company” sh.p.k. & “B93II” sh.p.k. & “Grama” sh.p.k. ka paraqitur preventivin e punimeve në formularin e ofertes me njësi të ndryshuar nga ato të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, konkretisht,

Sipas Preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor, është përcaktuar:

Shtrese çakelli t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri per bankina,B=50cm – **njesia m2**

Sipas preventivit të ofertes ekonomike të paraqitur nga ofertuesi ekonomik “Rafin Company” sh.p.k. është përcaktuar:

Shtrese çakelli t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri per bankina,B=50cm – **njesia m3**

Ndryshimet e preventivit të publikuar nga AK në njësi apo sasi nga operatorët ekonomik gjatë paraqitjes së ofertave ekonomike janë në kundërshtim me DST, konkretisht:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

B. PËRGATITJA E OFERTAVE

4. **Dokumentet përbërëse të Ofertës** Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor.

6. Çmimet

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

19. **Përgjegjshmëria e ofertave** 1. Një ofertë e përgjegjshme/ vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) **"Devijim"** është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;

Se dyti, bashkimi i operatoreve ekonomik "Rafin Company" sh.p.k. & "B93II" sh.p.k. & "Grama" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: Sipas Shtojca 1 Formulari i Ofertes, është dhënë cmimi pa tvsh 61,589,176 Leke. Pas kontrollit të ofertes ekonomike rezultoi se cmimi pa tvsh duke llogaritur vlerën e Fondit Rezerve 2% është: 62,820,959.52 Leke.

Se treti, bashkimi i operatoreve ekonomik "Rafin Company" sh.p.k. & "B93II" sh.p.k. & "Grama" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika 2.3.3/b) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik të cilet të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:***

- | | |
|---|----------------|
| ➤ Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastruktura | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Gjeodet / Topograf | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Hidroteknike | 1 (një) |

*Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). ***Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Shoqëria "Grama" sh.p.k. ka marrë përsiper 0.88% të përfaqësimit dhe punimet që kërkojnë disponimin e inxhinier ndërtimi profile infrastrukture, i ka marrë përsiper shoqëria "Rafin Company" sh.p.k. dhe shoqëria "B93II" sh.p.k. Asnjëri nga këta anëtar të BOE nuk disponojnë drejtues teknik inxhinier ndërtimi profile infrastrukture.*

Se katerti, bashkimi i operatorëve ekonomik “Rafin Company” sh.p.k. & “B93II” sh.p.k. & “Grama” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika **2.3.4 Makineri Pajisje Operatori Ekonomik** pjesëmarres duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 60 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, si më poshtë: Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesinë e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm). Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Konkretisht, nuk ka paraqitur numrin e kontrates noteriale të qerases (Rep. / Kol.) / furnizimit apo nuk ka vetëdeklaruar kontraten përkatëse noteriale të qerasë objekt i këtij prokurimi për mjetet:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton	copë	2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	copë	1
4	Autovinc	copë	1
6	Autopompe betoni	copë	1
7	Autobot uji	copë	1
9	Dumper	copë	1

13	Autobitumatriçe	copë	1
17	Eskavator me goma	copë	1
20	Kontenier Stacioner	copë	1

Se pesti, bashkimi i operatoreve ekonomik “Rafin Company” sh.p.k. & “B93II” sh.p.k. & “Grama” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika **2.3.5 Operatoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:**

- i. Çertifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shoqeria “Grama” sh.p.k. nuk ka kryer mirembajtjen vjetore per ISO 9001 – 2015, sipas certifikates AQS/Q/121902024

- ii. Çertifikate ISO 14001-2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shoqeria “Grama” sh.p.k. nuk ka kryer mirembajtjen vjetore per ISO 14001 – 2015, sipas certifikates AQS/A/121912024

- iii. Çertifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurimit në Pune”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shoqeria “Grama” sh.p.k. nuk ka kryer mirembajtjen vjetore per ISO 45001 – 2018, sipas certifikates AQS/S/121922024

- iv. Çertifikate ISO 39001-2012 Per menaxhimin e Sigurisë së Qarkullimit Rrugor, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shoqeria “Grama” sh.p.k. nuk ka kryer mirembajtjen vjetore per ISO 39001 – 2012, sipas certifikates AQS/RTS/121932024

Rafin nuk eshte bere mirembajtja e certifikatave Iso pasi ka perfunduar afati me date 16.02.2026.

Se gjashti, bashkimi i operatoreve ekonomik “Rafin Company” sh.p.k. & “B93II” sh.p.k. & “Grama” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika **2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”**. Shoqeria Grama shpk nuk disponon licencen me kodin III.2.B kurse referuar ndarjes se punimeve ka marr persiper realizimin e zerit te punimeve: Transport dheu me auto deri 3.0 km

Se shtati, bashkimi i operatoreve ekonomik “Rafin Company” sh.p.k. & “B93II” sh.p.k. & “Grama” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, pika **2.3.7 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më**

poshtë: - Tuba metalik D=219mm; - Tombino me tuba betoni Ø 800, **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.*
- *Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. **Shënim:** Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.*
- *Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë çertifikatë nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.*

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar. **Shënim:** Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do të referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.*

Për artikullin: Tuba metalik D=219mm mungon iso 9001 dhe 14001 nga prodhuesi. Mungon vertetimi njesimi me origjinalin i dokumentacionit të paraqitur nga kompania prodhuese.

Shoqeria “B93II” sh.p.k. ka deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit shtojca 8 mjetin tip Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton me targa AB644AA me shasi VF622GVA000118889, sipas kontrates se qerases REP 2950 KOL 945. Ky mjet eshte deklaruar edhe nga shoqeria “Shendelli” sh.p.k. sipas kontrates se qerases Rep 5305 kol 1498. Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e operatorit ekonomik

6. BOE GRIALD & INA

J68117216C / J61814009W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 67,568,602 (Gjashtedhjetë e shtatë milion e pesëqind e gjashtedhjetë e tete mijë e gjashtëqind e dy) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si me poshte:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi, rezulton se nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: Se pari, bashkimi i operatoreve ekonomik “Griald” sh.p.k. & “Ina” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3

Kapaciteti teknik: 2.3.1 Operoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
6. Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikaten e përhershme të marrjes në dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Leje për kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
5. Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e përhershme të marrjes në dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Shenim: Për punet e ngjashme të realizuara si BOE krahas dokumenteve të mesiperme duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku përcaktohet ndarja e zerave të punimeve ndërmjet paleve, ndërsa për punet e ngjashme të realizuara si nënkontraktor duhet të paraqitet edhe kontrata e nënkontraktimit ku përcaktohen zërat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

Shoqëria “Ina” sh.p.k. në kundërshtim me kërkesat e veçanta për kualifikim, nuk ka paraqitur faturat tatimore të shitjes për kontratën me objekt “Nderim Rrugët Pjeshkore + Velipoje+rrugicat + Rruga Pingul me Hekuran Deda + Rruga Ballsh (Vazhdim) Bashkia Kamez”, e cila është paraqitur si pune e

ngjashme. Shoqëria “Griald” sh.p.k. ka paraqitur disa kontrata shërbimi mirembajtje rruge dhe jo kontrata për realizimin e punimeve sipas objektit të prokurimit.

Se dyti, bashkimi i operatoreve ekonomik “Griald” sh.p.k. & “Ina” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.3.4 Makineri Pajisje Operatori Ekonomik** pjesëmarres duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 60 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Për artikullin: Tuba metalik D=219mm mungon vertetim njesimi me origjinalin i dokumentave të paraqitura nga distributori i autorizuar “Haki Sinani” sh.p.k. Shoqëria “DESARET COMPANY” sh.p.k. referuar ekstraktit mbi historikun e kompanise rezulton se me datë 25.05.2026 ka të regjistruar:

23/04/2026 Numri i ceshtjes: CN-598358-04-26 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim i Urdhërit Nr.1910/5 Dosje, datë 14.04.2026, lëshuar nga Përmbartuesi Gjyqësor privat Dionis Mekshaj ku është urdhëruar: Sekuestrimin e aktiveve te Shoqeria " DESARET COMPANY " sh.p.k me NIPT K01816001J me adrese; Rruga "Hysen Gerblli", Pallati "Desaret", Prane Kryqit te Kuq, Kati perdhe, Tirane deri ne nje urdher te dyte te permbartuesit gjyqesor. Lista e Dokumenteve: Çdo regjistrim tjetër i të dhënave të regjistruara. (Dokumente Te tjera) Vendimi/Akti i Gjykatës, Zyrës Përmbartimore ose Autoritet tjetër publik.

1. Në Dokumentat Standarte te Tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar se:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë:

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë:

- Kapaciteti ekonomik dhe financiar, Pikat 2.2.1, 2.2.2, Shtojca 7 e DST-së.

- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas Pikës 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të KVK, Shtojca 7 e DST-së.
- Licencat e kërkuara sipas pikës 2.3.2/a, 2.3.2/b, **2.3.4** të Kapacitetit Teknik të KVK, Shtojca 7 e DST-së.
- Staf i teknik i kërkuar sipas pikës 2.3.3 / b të Kapacitetit Teknik të KVK, Shtojca 7 e DST-së.

Ofertuesve nuk u lejohej të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për pikat si më sipër, pasi përvoja për të zbatuar kontratën, licencat dhe stafi teknik vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standardeve të kërkuara.

Sa me sipër mjetet e paraqitura me deklarate mbështetje nga shoqëria “REJ” sh.p.k. me targa AA087TT, XB466FP, AB626KN nuk plotësojnë kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e operatorit ekonomik

9. BE - IS SH.P.K

K71412003A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 74,415,392 (Shtatëdhjetë e katër milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e nentëdhjetë e dy) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi, rezulton se nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: Se pari, operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3**; Operatori ekonomik ka paraqitur sigurimin e ofertes në kundërshtim me kërkesat për kualifikim, pasi, nuk plotëson elementet juridik dhe formal të parashikuar nga ligji. Konkretisht formulari i sigurimit të ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik, nuk është i vulosur nga kompania e sigurimit e cila e ka leshuar, si dhe nuk është firmosur nga agjenti dhe as nga i siguruari mungon firma dhe vula

Se dyti, operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: Formulari i ofertes ekonomike nuk është paraqitur sipas formatit të miratuar nga APP në Dokumentat Standarte të Tenderit, për procedurën e hapur, pune, me mjete elektronike, dhe të publikuar nga autoriteti kontraktor në SPE. Operatori ekonomik, ka paraqitur formularin e ofertes ekonomike me përmbajtje të ndryshme nga formati i miratuar nga APP. Gjithashtu, çmimi i shprehur me fjale nuk përputhet me çmimin

e shprehur me shifra, pasi ka gabime të shumta drejtshkrimore duke e bere të pamundur përputhshmerine e ofertes ekonomike të shprehur me numra dhe me fjale.

Operatori ekonomik, ka paraqitur formulare me përmbajtje të ndryshme nga formularet e publikuar nga AK, në kundërshtim me DST, konkretisht:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

B. PËRGATITJA E OFERTAVE

- 5. Dokumentet** Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga
përbërëse të Autoriteti/Enti Kontraktor.
Ofertës

6. Çmimet

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

- 20. Përgjegjshmëria e ofertave** 1. Një ofertë e përgjegjshme/ vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;

Se treti, operatori ekonomik "BE - IS" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: Ka gabime ne preventivin e punimeve ne zerin:

Sipas preventivit të publikuar në SPE

Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri per bankina,B=50cm;

Sipas preventiv ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik

Shtrese gakeili t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri per bankina,B=50cm

Sipas preventivit të publikuar në SPE

Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri

Sipas preventiv ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik

Shtrese gakeili mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri

Sipas preventivit të publikuar në SPE

Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese beton

Sipas preventiv ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik

Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese beton

Sipas preventivit të publikuar në SPE

Struktura te holla monolite betoni C 25/30,Beton per puseta tombino+tuba **çeliku**+portale

Sipas preventiv ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik

Operatori ekonomik, ka paraqitur preventiv oferten me përmbajtje të ndryshme nga preventivi i publikuar nga AK, në kundërshtim me DST, konkretisht:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

B. PËRGATITJA E OFERTAVE

- 6. Dokumentet përbërëse të Ofertës** Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor.

6. Çmimet

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasitë dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

- 21. Përgjegjshmëria e ofertave** 1. Një ofertë e përgjegjshme/ vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) **"Devijim"** është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;

Se katerti, operatori ekonomik "BE - IS" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht, pika **2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1** *Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Formularin e vlerësimit;*
- 2. Kontratën/Kontratat;*
- 3. Situacionin përfundimtar;*
- 4. Akt Kolaudimi*
- 5. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;*
- 6. Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikaten e perhershme të marrjes në dorezim*

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Kontratë sipermarrje;*
- 2. Leje për kryerje punimesh*
- 3. Situacionin përfundimtar;*
- 4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;*
- 5. Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e përhershme të marrjes në dorezim;*

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Për punet e ngjashme të realizuara si BOE krahas dokumenteve të mesiperme duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku përcaktohet ndarja e zerave të punimeve ndermjet paleve, ndersa për punet e ngjashme të realizuara si nenkontraktor duhet të paraqitet edhe kontrata e nenkontraktimit ku përcaktohen zërat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

Operatori ekonomik për plotësimin e këtij kriteri, ka paraqitur dokumentacion për kontratën me objekt “Rehabilitimi Infrastruktues rrugore ne Njësinë Administrative Dajt + Shen Gjergj + Zall Bastar“. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për këtë objekt, rezulton se, Proçes Verbal i Marrjes në Dorëzim të Përkohshëm nuk është firmosur nga Drejtuesi Teknik i kolaudatorit Ing. Anton Pjetërnikaj.

Se pesti, operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht, pika 2.3.3 / e Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 16 (Gjashtembedhjetë) punonjes të kualifikuar për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certificate trajnimi (të vlefshme), ose Deshmi Profesionale leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë, si më poshtë:

<i>Teknik Ndertimi</i>	<i>1 (nje)</i>
<i>Teknik Topograf</i>	<i>1 (nje)</i>
<i>Hidraulike</i>	<i>1 (nje)</i>
 <i>Karpentier</i>	 <i>2 (dy)</i>
 <i>Asfaltoshtrues</i>	 <i>3 (tre)</i>
<i>Betonues</i>	<i>2 (dy)</i>
<i>Specialist Ndertimi</i>	<i>3 (tre) 1</i>
<i>Shofer</i>	<i>3 (tre)</i>

Shoferet për drejtim mjetesesh duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi me kategorine “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE” leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor. Për

secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. **Shënim:** Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t’i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës. *** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Operatori ekonomik ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca 8 se për plotësimin e kriterit të kërkuar nga autoriteti kontraktor - Teknik topograf, është deklaruar Egli Avllazagaj, i cili rezulton i diplomuar inxhinier Gjeodet. Pra, ky operator ekonomik nuk ka arritur të provojë se disponon Teknik Topograf, në kundërshtim me kërkesat për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Se gjashti, shoqëria “BE - IS” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.3.4 Makineri Pajisje** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për Sigurinë në Kantier”, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|---------|
| ➤ Kokore minimumi | 60 copë |
| ➤ Prozhektorë ndriçimi natën minimumi | 4 copë |
| ➤ Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi | 5 copë |
| ➤ Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi | 20 copë |

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesinë e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm). Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata perkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm). Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori

ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Shoqëria “BE - IS” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pasi, nuk ka paraqitur numrin e kontrates noteriale të qerash (Rep. / Kol.) / furnizimit apo nuk ka vetedeklaruar kontraten përkatëse noteriale të qerash objekt i këtij prokurimi për mjetet:

Nuk ka vetedeklaruar kontraten përkatëse noteriale të qerash objekt i këtij prokurimi për mjetet:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
22	Fabrikë për prodhimin e Asfaltit, e pajisur me leje mjedisore nga QKL	copë	1	Në pronësi ose me qera ose furnizimi
23	Implant për prodhimin e Betonit, të pajisur me leje mjedisore nga QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronesinë. Në rast se implanti i prodhimit të betonit është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerash.	copë	1	Në pronësi ose me qera ose furnizimi
28	Sperkates boje për vijezime në rrugë	copë	1	Në pronësi ose me qera

Se shtati, shoqëria “BE - IS” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara në këtë procedurë prokurimi nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.*

Shoqëria “BE - IS” sh.p.k. ka deklaruar se mjetet dhe pajisjet nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Bashkia Has. Kjo deklaratë nuk është e plotë me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, i cili ka përcaktuar se kërkon deklarata nga operatorët ekonomik se makineritë dhe pajisjet e deklaruara për këtë procedurë prokurimi nuk janë të deklaruara në procedurë të tjera të shpallura fitues.

Se teti, shoqëria “BE - IS” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika: **2.3.5** *Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:*

- *Certifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikate ISO 14001-2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Punë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikate ISO 39001-2012 Për menaxhimin e Sigurisë së Qarkullimit Rrugor, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*

Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto çertifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Operatori ekonomik nuk ka kryer mirembajtjen vjetore për ISO 45001-2023 me numer çertifikate AQS/S/143862025.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e operatorit ekonomik

10. PE - VLA - KU

K61716013M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 75,233,154.08 (Shtatëdhjetë e pesë milion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër pike zero tete) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO X JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat: SAJS, me Nipt K92316501M, 50% nenkontraktimi

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si me poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi, rezulton se nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht:

Se pari, operatori ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.2.1.** *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.* Ky operator ekonomik nuk ka arritur të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, pasi ka paraqitur vërtetim xhiro fotokopje, për shoqërinë “PE-VLA-KU” sh.p.k. degen në Kosovë. Në Dokumentat Standarte të Tenderit, është përcaktuar se: Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Se dyti, operatori ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.2.2** *Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e*

përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Ky operator ekonomik nuk ka arritur të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, pasi Bilanci 2023 është paraqitur i pa konfirmuar nga administrata tatimore për shoqërinë "PE-VLA-KU" sh.p.k. dëgjen në Kosovë.

Se treti, operatori ekonomik "PE-VLA-KU" sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika

2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1 Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratën;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
6. Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e përhershme të marrjes në dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Leje për kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
5. Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e përhershme të marrjes në dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarët e cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Shenim: Për punët e ngjashme të realizuara si BOE krahas dokumenteve të mesiperme duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit ku përcaktohet ndarja e zerave të punimeve ndërmjet paleve, ndërsa për punët e ngjashme të realizuara si nenkontraktor duhet të paraqitet edhe kontrata e nenkontraktimit ku përcaktohen zërat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

Ky operator ekonomik për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur dokumentacion për kontratën me objekt "Ndërtim i rrjetit rrugor dhe Infrastruktura urbane të zonës Durrës 4 Spitalë, Njesia Administrative Spitalë, Bashkia Durrës". Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor,

konkretisht, ka paraqitur vetem 1 fature tatimore shitje me vlerë 3,449,181 Leke me t.v.sh. Pra, nuk ka paraqitur të gjitha faturat tatimore të shitjes, sipas kërkesave për kualifikim. Situacioni përfundimtar nuk është paraqitur i vulosur nga autoriteti kontraktor.

Se katerti, operatori ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3 / a **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:**

a) *Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar të paktën 60 (Gjashtedhjetë) punonjes me kohe të plotë duke përfshirë dhe stafin teknik, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mësipërme në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:*

- *Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.*
- *Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shoqëria “PE-VLA-KU” sh.p.k. në kundërshtim me kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, nuk ka deklaruar numrin e punonjësve që disponon për periudhën Prill 2026. Proçedura e prokurimit është zhvilluar me datë 25.05.2026, dhe deklarimi i periudhës Prill 2026 është deri me datë 20 Maj 2026.

Se pesti, operatori ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika f) **Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:**

- *Ekskavatoriste* 3 (tre)
- *Automakinist* 3 (tre)

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për manovratorët nga kompania “Alesio” sh.p.k. dhe “Arifaj” sh.p.k. kontrate pune / sherbimi, sipas kontratave për qera për mjetet e vetëdeklaruar.

Se gjashti, operatori ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.4 **Makineri Pajisje** *Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabeles së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:*

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 60 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesinë e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm). Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata perkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm). Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik nuk ka deklaruar disponimin e mjetit “fadrome me goma” të pajisur me dokumentacioni që vërteton pronesinë e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi, shasia etj.

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi
18	Fadrome me goma	copë	1

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mësipërme, mjete të cilat i ka deklaruar në Formularin e vetëdeklarimit por që janë pa targa. Referuar nenit 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” pika 1, e ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet: 1. “Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod”, klasifikohen si vijon:

k) mjete teknologjike

Në nenin 58, pika 1 dhe 2, parashikohet: 1. “Mjetet teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë”. 2. “Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, mjetet teknologjike ndahen në: a) mjete që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut”. Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet: “Për të qarkulluar në rrugë mjete teknologjike me goma, duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit”. Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor)”, pika 1, parashikohet: “Makinat, të cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas nenit 113 të Kodit

Rrugor, duhet të regjistrohen prane deges se DRShTRr-se rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes se qarkullimit dhe të targes të atij që deklarohet pronar i mjetit.” Referuar pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku citohet: AK kerkon mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën” si dhe bazuar ne percaktimet ligjore te ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Njesia e Prokurimit është shprehur qartazi ne kerkesat e DST per llojin e mjetit qe kerkon, ne menyre qe plotesimi i kesaj pike te mos jete konfuze per OE. (Referuar Vendimit 225/2023 te KPP).

Se shtati, operatori ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.3.5** *Operatoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:*

- *Certifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikate ISO 14001-2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurimit në Pune”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikate ISO 39001-2012 Per menaxhimin e Sigurisë së Qarkullimit Rrugor, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*

Nëse certifikatat janë në gjuhe të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë leshuar nga nje organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsiper të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shoqëria “PE-VLA-KU” sh.p.k. ka paraqitur ISO 39001-2012 e cila nuk është bere mirembajtja vjetore per certifikaten AQS/RTS/103742023.

Se teti, operatori ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika **2.3.7** *Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë: - Tuba metalik D=219mm, - Tombino me tuba betoni Ø 800, **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:***

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve.*

Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

- *Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. **Shënim:** Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.*
- *Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë çertifikatë nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.*

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar. **Shënim:** Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.*

Për artikullin Tuba metalik D=219mm, është paraqitur autorizim distributor nga shoqëria “Italinox” sh.p.k. Mungon autorizim prodhimi ose distributor i autorizuar, si dhe nuk janë paraqitur iso 9001 – 2015 dhe 14001-2015 të përkthyer në gjuhën shqipe. Për artikullin Tombino me tuba betoni Ø 800 nuk është paraqitur për shoqërinë “PE-VLA-KU” sh.p.k.

Se nenti, operatori ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën **ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).** Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Bashkisë Has, e përcaktuar edhe tek Pika 2.10 e DST-së. Financimi është parashikuar në Buxhetin 2026-2028, afati i realizimit është 8 muaj.

Nuk është paraqitur deklarata për dakortesinë e financimit nga operatori ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k. dege e kompanisë në Kosovë.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e operatorit ekonomik

6. VELLEZERIT HYSA

K12911201C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 77,891,696.36 (Shtatedhjetë e shtatë milion e teteqind e nentëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e nentëdhjetë e gjashtë pike tridhjetë e gjashtë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit janë si me poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi, rezulton se nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht:

Se pari, operatori ekonomik “Vellezerit Hysa” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.3.3 / b Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik të cilet të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:**

- | | |
|---|----------------|
| ➤ Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastruktura | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Gjeodet / Topograf | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Hidroteknike | 1 (një) |

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). *** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Operatori ekonomik “Vellezerit Hysa” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca 8 nuk ka deklaruar se disponon staf drejtues teknik Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastruktura 1 (një) dhe Inxhinier Hidroteknik 1 (një). Ky operator ekonomik ka deklaruar Ing. Orneta Baku me profesion Inxhinier Hidroteknik, me master shkencor në profilin “Inxhinieri Infrastruktura Transporti”, e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit teknik dhe “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomik të disponojnë 2 inxhinier të ndryshëm drejtues teknik, Inxhinier Ndërtimi, profile Infrastruktura, një kërkesë e tillë është e domosdoshme për shkak të proceseve të punës të parashikuara për realizimin e shtresave asfaltike, dhe inxhinier hidroteknik drejtues teknik për shkak të realizimit të punimeve të kanalizimeve etj. Sa më sipër, ky operator ekonomik nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim.

